

1917  
9.11.22

## BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SH.A

Nr. 257 Prot.

Tiranë, më 03/11 /2022

**Lënda:** Informim mbi tregtimin e kontratave të lidhura ndërmjet dy pjesëmarrësve të tregut jashtë bursës (Over the Counter - OTC) në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.

**Drejtuar:** **Entit Rregullator të Energjisë**  
Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimi” Nr. 1023, Tiranë.

**Inderuar z. Ahmeti,**

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, në kuadër të detyrimeve dhe angazhimeve të ndërmarrja, tashmë në cilësinë e të licencuarit si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike, sipas vendimit të Bordit të ERE nr. 247, datë 29.09.2022, duke pasur parasysh rolet dhe përgjegjësitë e këtij funksioni është duke punuar për të propozuar pranë Entit Rregullator të Energjisë plotësimin e kuadrit të nevojshëm rregulator në lidhje me aktivitetin e saj.

Në vijim të kërkesës së paraqitur nga ana e ALPEX-it për miratimin e Rregullave dhe Procedurave të ALPEX, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a, Ju informon si do të veprohet me tregtimin e kontratave të brendshme afatgjatë dypalëshe (OTC) të cilat do të bazohen në një kontratë financiare, ku energjia elektrike fizike do të tregtohet nëpërmjet Bursës.

Ky informacion ju bëhet me dije duke marrë në konsideratë parashikimet e kapitullit B. 2 “Trupa organizative e tregut dhe rolet e tyre”, të Rregullave të ALPEX-it-Kushtet e Përgjithshme, e cila ka për qëllim të lehtësojë livrimin fizik të tregtimit të kontratave të brendshme afatgjatë dypalëshe (OTC) të cilat do të bazohen në një kontratë financiare, ku energjia elektrike fizike do të tregtohet nëpërmjet Bursës.

Në kushtet kur me fillimin e operimit të ALPEX, mungesa e likuiditetit të mjaftueshëm do mund të sillte që në disa Njësi Kohore Tregu të pamundësohej rezultati dhe për rrjedhojë mund të krijonte probleme sidomos në tregtimin e kontratave të brendshme afatgjatë dypalëshe (OTC), ALPEX sh.a ka vlerësuar që këto kontrata të mos tregtohen në Bursë që nga operacionalizimi i saj, por në një moment të dytë, kur ALPEX-i do të vlerësojë se është garantuar likuiditeti dhe krijuar kushtet e nevojshme për të filluar tregtimin e tyre, duke

vlerësuar se ky vendim është i domosdoshëm dhe i drejtë për funksionimin e duhur të tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike.

Përsa më sipër, informojmë:

- Kontratat e brendshme afatgjata dypalëshe (Over the Counter - OTC) të cilat do të bazohen në një kontratë financiare, ku energjia elektrike fizike do të tregtohet nëpërmjet Bursës, do të prezantohen për tregtim në Bursë jo që në momentin fillestar të operacionalizimit të saj, por në një moment të dytë, kur ALPEX-i do të vlerësojë se është garantuar likuiditeti dhe janë krijuar kushtet e nevojshme për të filluar tregtimin e tyre dhe do t'ju informojë paraprakisht për këtë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi të hapur për çdo kërkesë apo sqarim të mundshëm.

Me respekt,

**ADMINISTRATOR i ALPEX sh.a**

Sokol Dishnica

